



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

**PROJEKTVENDIM**

Nr 084, Datë 19. 01 . 2026

**Për një ndryshim në VKB nr.113, datë 15.12.2025 “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrorit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; dhe shkresës Ministrorit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr.764, datë 19.12.2025 “Shkresë përcjellëse mbi vendimin përfundimtar të KVA-së në kuadër të GBP 2025”, Kryetari i Bashkisë i paraqet projektin përkatës Këshillit të Bashkisë;

**Për të vendosur :**

1.Miratimin e një ndryshimi në Buxhetin e Vitit 2026, konkretisht në:

- Pikën 1/a “Plani i të ardhurave” shtohen burimet në shumën 3,222,170.24 lekë, grant i bazuar në performancë për vitin 2025 me burim financimi nga financimi i huaj.
- Pikën 1/b “Plani i shpenzimeve” shtohen shpenzimet në shumën 3,222,170.24 lekë, në Programin Buxhetor AB127 “Rendi dhe Siguria Publike”, në Funksinin “10910”.

2.Miratimin e përdorimit të fondit me burim financimi të huaj për projektin: “Ndërtim pritash malore në dy degëzimet e Përroit të Bardhë dhe rehabilitim i urës në fshatin Zejmen, Nj.Administrative Zejmen” në shumën 3,222,170.24 lekë.

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngakohen: Drejtoria e Emergjencave Civile, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, e ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

**KRYETARI**

**Pjerin Ndreu**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. 684/ Prot

Lezhë, më 15. 01.2026

RELACION

LIDHUR ME PROJEKTVENDIMIN E PARAQITUR PËR PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË  
PERFORMANCËS PËR VITIN 2025, ME BURIM FINANCIMI NGA FINANIMI I HUAJ

Të nderuar këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; në ligjin nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; i ndryshuar; në shkresën e Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr.764, datë 19.12.2025 “Shkresë përcjellëse mbi vendimin përfundimtar të KVA-së në kuadër të GBP 2025” dhe në shkresën e Ministrisë së Financave nr.18133/1, datë 24.12.2025 “Detajimi i Fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për Bashkitë për vitin 2025”, ju relatoj lidhur me projektvendimin e paraqitur “Për miratimin e një ndryshimi në VKB nr.113, datë 15.12.2025 “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026”” dhe përdorimin e fondit me burim financimi nga financimi i huaj, për zbatimin e projektit: “Ndërtim pritash malore në dy degëzimet e Përroit të Bardhë dhe rehabilitim i urës në fshatin Zejmen, Nj. Administrative Zejmen” në shumën 3,222,170.24 lekë.

Referuar Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr.20, datë 11.07.2025 dhe nr.01, datë 11.07.2025 “Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të grantit të bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025, pika B.8, Këshilli i Bashkisë duhet të marrë vendimin përkatës për përcaktimin e destinacionit të përdorimit të këtij fondi.

Prandaj, ju propozoj miratimin e përdorimit të këtij fondi me burim financimi të huaj, për ndërhyrje parandaluese dhe emergjente, për të shmangur dëmtimin e banesave pranë Përroit të Bardhë në fshatin Zejmen, për të mundësuar zbatimin e projektit: “Ndërtim pritash malore në dy degëzimet e Përroit të Bardhë dhe rehabilitim i urës në fshatin Zejmen, Njësia Administrative Zejmen” në shumën 3,222,170.24 lekë

Bashkëlidhur do të gjeni shkresat përkatëse dhe Udhëzimin e Përbashkët.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI  
Pjerin Ndreu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 523 Prot

Lezhë, më 15/01/2026



Lëndë: Kërkesë për akordim dhe përdorim fondi.

**DREJTORISË SË FINANCËS DHE BUXHETIT**

**KËTU**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015''Për Vetëqeverisjen Vendore'', Ligji Nr.68 date 24.07.2017 ''Per Financat e Vetëqeverisjes Vendore'',Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.9 datë 20.03.2018 ''Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, dhe në shkresën Nr.764 prot date 19.12.2025 mbi shpërndarjen e fondit sipas bashkive dhe burimit të financimit në kuadër të GPB 2025, kërkoj akordimin dhe përdorimin e fondit në shumën 3,726,149.64 lekë për :

- Ndërtim pritash malore në dy degezimet e Perroit të Bardhë, dhe Rehabilitim i Urës në fshatin Zejmen, Njësia Administrative Zejmen, sipas zërave më poshtë :

- Punime ndërtimi me vlerë prej 3,491,149.64 lekë.
- Mbikqyrje punimesh me vlere prej 120,000 lekë.
- Kolaudim punimesh me vlerë prej 35,000 lekë.
- Oponence teknike me vlerë prej 50,000 lekë.
- Vleresimi ndertimit mjedisit (VNM) me vlerë prej 30,000 lekë.

Shuma totale prej **3,726,149.64 lekë** do të financohet nga fondi me burim financimi të huaj në shumën prej 3,222,170.24 lekë, ndersa shuma prej 503.979.4 lekë do të financohet me fondet e bashkise.

Duke ju falenderuar,

**DREJTORI**  
**Gjergj PRENDI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

**Relacion**

**Mbi akordim dhe perdorim fondi.**

Si rezultat i prurjeve të mëdha nga reshjet me intensitet të lartë dhe mungeses së pritave malore krijohen përmbytje në fshatin Zejmen, Njësia Administrative Zejmen Bashkia Lezhe, ku ujrato Perroit të Bardhë e përmbytin uren, në këto kushte uji del mbi urë duke sjellë përmbytje të zonës.

E shohim të domosdoshme ndertimin e dy pritave malore dhe rehahabilitimin e ures ekzistuese. Kjo ndërhyrje bën të mundur sistemimin e grumbullimeve të ujrave të dy degezimeve të Perroit të Bardhë me qëllim që mos të dëmtohen banesat pranë përroit në fshatin Zejmen.

Projekti ka një kosto prej 3,726,149.64 lekë konkretisht,

- Punime ndërtimi me vlerë prej 3,491,149.64 lekë.
- Mbikqyrje punimesh me vlere prej 120,000 lekë.
- Kolaudim punimesh me vlerë prej 35,000 lekë.
- Oponence teknike me vlerë prej 50,000 lekë.
- Vleresimi ndertimit mjedisit (VNM) me vlerë prej 30,000 lekë.


Kërkojmë që të financohet nga fondi me burim financimi të huaj në shumën prej 3,222,170.24 lekë, ndersa shuma prej 503.979.4 lekë do të financohet me fondet e bashkise.

Duke ju falenderuar,

**DREJTORI**  
**Gjergj PRENDI**

**Formati i Fish / Projektit Emërtimi i objektit :** Ndërtim pritash malore në dy degezimet e Perroit të Bardhë, dhe Rehabilitim i Urës në fshatin Zejmen, Njësia Administrative Zejmen

**Personat e Kontaktit**

Emri i propozuesit të projektit	Bashkia Lezhë Drejtorja e Emergjencave Civile	Firma e propozuesit të Projektit	
Të dhëna të detajuara për projektin	Ndërtim pritash malore në dy degezimet e Perroit të Bardhë, dhe Rehabilitim i Urës në fshatin Zejmen, Njësia Administrative Zejmen		
Institucioni Buxhetor/ Ministria /grupi / sektori	Bashkia Lezhë	Vendodhja e projektit	Bashkia Lezhë



**Identifikimi i Idesë së Investimit**

Projekt / Idea	
Problemet për t'u adresuar	Si rezultat i prurjeve të mëdha nga reshjet me intensitet të lartë dhe mungesës së pritave malore krijohen përmbytje në fshatin Zejmen, Njësia Administrative Zejmen Bashkia Lezhe, ku ujrart e Perroit të Bardhë e përmbytin uren, në këto kushte uji del mbi urë duke sjellë përmbytje të zonës. Fshati Zejmen ka 1450 banore, ndër to 700 meshkuj dhe 750 femra. E shohim të domosdoshme ndërtimin e dy pritave malore dhe rehaabilitimin e ures ekzistuese. Projekti ka një kosto prej 3,726,149.64 lekë .Do të financohet nga fondi me burim financimi të huaj në shumën prej 3,222,170.24 lekë, ndersa shuma prej 503.979.4 lekë do të financohet me fondet e bashkise.
Emri i Programit	Rendi dhe Siguria Publike
Kodi i programit	AB127
Qëllimet dhe objektivat e Programit të cilat projekti do të ndihmojë të arrihen	Kjo ndërhyrje bën të mundur sistemimin e grumbullimeve të ujrave të dy degezimeve të Perroit të Bardhë me qëllim që mos të dëmtohen banesat pranë perroit në fshatin Zejmen.

**Kostot e Projektit të Investimit**

Kosto e zbatimit projektimit	3,491,149.64
Mbikqyrje punimesh	120,000
Kolaudim	35,000
Oponence teknike	50,000
VNM	3,726,149.64
<b>Kosto Totale e Projektit në mijë lekë</b>	

**Autorizuesit /Hapat e aprovimit të projekt / idesë**

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit Statusi i Projektit Idesë
Drejtuesi i Programit	Ferdinand Preçi		12.01.2026	Ndërtim pritash malore në dy degezimet e Perroit të Bardhë, dhe Rehabilitim i Urës në fshatin Zejmen, Njësia Administrative Zejmen
Komente nga Drejtuesi i Programit (nqs ka)				
Zv/Kryetari i Bashkise (Koordinatori)	Brikena Vuksani		12.01.2026	Konfirmimi/refuzimi i aprovimit të projekt idesë.
Komente nga (Koordinatorit) (nqs ka)				





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE  
DREJTORIA E STATISTIKËS DHE PERFORMANCËS

Nr. 764 Prot.

Tiranë, më 19/12 .2025

**Lënda:** Shkresë përcjellëse mbi vendimin përfundimtar të KVA-së në kuadër të GBP 2025

**Drejtuar:**

**Z. ARIF TAFANI  
KRYETAR I BASHKISË BELSH**

**Z. ERVIN CECA  
KRYETAR I BASHKISË BERAT**

**ZNJ. FESTIME MJESHTRI  
KRYETAR I BASHKISË BULQIZË**

**Z. FLORENC DOKA  
KRYETAR I BASHKISË CËRRIK**

**Z. BESMIR VELI  
KRYETAR I BASHKISË DELVINË**

**Z. EDUARD DURO  
KRYETAR I BASHKISË DEVOLL**

**Z. RAHIM SPAHIU  
KRYETAR I BASHKISË DIBËR**

**ZNJ. JULIANA MEMAJ  
KRYETAR I BASHKISË DIMAL**

**Z. JOSIF GORREA  
KRYETAR I BASHKISË DIVJAKË**

**Z. DHIMITRAQ TOLI  
KRYETAR I BASHKISË DROPULL**

**ZNJ. EMIRIANA SAKO  
KRYETAR I BASHKISË DURRËS**

**Z. GLEDIAN LLATJA  
KRYETAR I BASHKISË ELBASAN**

**Z. ARMANDO SUBASHI**  
**KRYETAR I BASHKISË FIER**

**Z. ROMEO ÇAKULI**  
**KRYETAR I BASHKISË FINIQ**

**Z. HIL CURRI**  
**KRYETAR I BASHKISË FUSHË-ARRËS**

**Z. FLAMUR GOLEMI**  
**KRYETAR I BASHKISË GJIROKASTËR**

**Z. BESIION AJAZI**  
**KRYETAR I BASHKISË GRAMSH**

**Z. MIFTAR DAUTI**  
**KRYETAR I BASHKISË HAS**

**Z. VANGJEL TAVO**  
**KRYETAR I BASHKISË HIMARË**

**Z. RAKIP SULI**  
**KRYETAR I BASHKISË KAMËZ**

**Z. FISNIK QOSJA**  
**KRYETAR I BASHKISË KAVAJË**

**Z. KLEMENT NDONI**  
**KRYETAR I BASHKISË KËLCYRË**

**ZNJ. VALBONA KOLA**  
**KRYETAR I BASHKISË KLOS**

**Z. ERION ISAI**  
**KRYETAR I BASHKISË KOLONJË**

**Z. ERGEST DULE**  
**KRYETAR I BASHKISË KONISPOL**

**Z. SOTIRAQ FILO**  
**KRYETAR I BASHKISË KORÇË**

**Z. ARTUR BUSHI**  
**KRYETAR I BASHKISË KRUIJË**

**Z. KRESHNIK HAJDARI**  
**KRYETAR I BASHKISË KUÇOVË**

**Z. ALBERT HALILAJ**  
**KRYETAR I BASHKISË KUKËS**

**ZNJ. MAJLINDA CARA**  
**KRYETAR I BASHKISË KURBIN**

**Z. PJERIN NDREU**  
**KRYETAR I BASHKISË LEZHË**

**Z. LEONARD HIDE**  
**KRYETAR I BASHKISË LIBOHOVË**

**Z. MARIGLEN DISHA**  
**KRYETAR I BASHKISË LIBRAZHË**

**ZNJ. ERISELDA SEFA**  
**KRYETAR I BASHKISË LUSHNJË**

**Z. TONIN MARINAJ**  
**KRYETAR I BASHKISË MALËSI E MADHE**

**Z. GËZIM TOPÇIU**  
**KRYETAR I BASHKISË MALIQ**

**Z. QERIM ISMAILAJ**  
**KRYETAR I BASHKISË MALLAKASTËR**

**Z. ALTIN BOJNI**  
**KRYETAR I BASHKISË MAT**

**Z. ALBERT MALAJ**  
**KRYETAR I BASHKISË MEMALIAJ**

**Z. ALBERT MËLYSHI**  
**KRYETAR I BASHKISË MIRDITË**

**Z. FATION DURO**  
**KRYETAR I BASHKISË PATOS**

**Z. BUKUROSH MAÇI**  
**KRYETAR I BASHKISË PEQIN**

**ZNJ. ALMA HOXHA**  
**KRYETAR I BASHKISË PËRMET**

**Z. NURI BELBA**  
**KRYETAR I BASHKISË PËRRENJAS**

**Z. ILIR XHAKOLLI**  
**KRYETAR I BASHKISË POGRADEÇ**

**Z. ADRIATIK ZOTKAJ**  
**KRYETAR I BASHKISË POLIÇAN**

**Z. RROK DODAJ**  
**KRYETAR I BASHKISË PUKË**

**Z. PALI KOLEFSKI**  
**KRYETAR I BASHKISË PUSTEC**

**ZNJ. MAJLINDA BUFI**  
**KRYETAR I BASHKISË ROSKOVEC**

**Z. EDISON MEMOLLA**  
**KRYETAR I BASHKISË RROGOZHINË**

**Z. OLTION ÇAÇI**  
**KRYETAR I BASHKISË SARANDË**

**Z. NERTIL BELLAJ**  
**KRYETAR I BASHKISË SELENICË**

**Z. ELTON ARBANA**  
**KRYETAR I BASHKISË SHIJAK**

**Z. BENET BECI**  
**KRYETAR I BASHKISË SHKODËR**

**Z. ADRIATIK MEMA**  
**KRYETAR I BASHKISË SKRAPAR**

**Z. GRAMOS SAKO**  
**KRYETAR I BASHKISË TEPELENË**

**ZNJ. ANUELA RISTANI**  
**KRYETAR I BASHKISË TIRANË (NË DETYRË)**

**Z. REXHË BYBERI**  
**KRYETAR I BASHKISË TROPOJË**

**Z. KRISTIAN SHKRELI**  
**KRYETAR I BASHKISË VAU-DEJËS**

**ZNJ. BRUNILDA MERSINI**  
**KRYETAR I BASHKISË VLORË**

**Z. BLERIM SHERA**  
**KRYETAR I BASHKISË VORË**

**Për dijëni:**

**Z. ERVIN DEMO**  
**MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR**

Të nderuar,

Në mbështetje të Udhëzimit të Përbashkët nr. 1, datë 11.07.2025, "Për kriteret, procedurat dhe treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025", ju përcjellim bashkëlidhur **vendimin përfundimtar të Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve për shpërndarjen e grantit sipas bashkive dhe burimit të financimit në kuadër të GBP 2025.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM I KOMANDUAR  
Z. STILJAN LLAVDANITI**



Vendimi përfundimtar mbi shpërndarjen e fondit sipas bashkive dhe burimit të financimit në kuadër të GBP 2025

Bashkia		GBP 2025				Burimi	
		Pesha në %	Shuma Fikse	Shuma Shtesë	Total	I brendshëm	I huaj
Nr.	Total	0.36	163,124,683.82	284,093,550.48	447,218,234.30	200,000,000.00	247,218,234.30
1	Belsh	0.24	1,759,547.15	3,064,379.87	4,823,927.02	2,157,303.37	2,666,623.65
2	Berat	0.30	2,199,433.94	3,830,474.84	6,029,908.78	2,696,629.21	3,333,279.56
3	Bulqizë	0.45	3,299,150.91	5,745,712.26	9,044,863.17	4,044,943.82	4,999,919.35
4	Cërrik	0.49	3,592,408.77	6,256,442.24	9,848,851.00	4,404,494.38	5,444,356.62
5	Delvinë	0.44	3,225,836.44	5,618,029.76	8,843,866.21	3,955,056.18	4,888,810.03
6	Devoll	0.15	1,099,716.97	1,915,237.42	3,014,954.39	1,348,314.61	1,666,639.78
7	Dibër	0.55	4,032,295.56	7,022,537.20	11,054,832.76	4,943,820.22	6,111,012.53
8	Dimal	0.39	2,859,264.12	4,979,617.29	7,838,881.41	3,505,617.98	4,333,263.43
9	Divjakë	0.39	2,859,264.12	4,979,617.29	7,838,881.41	3,505,617.98	4,333,263.43
10	Dropull	0.59	4,325,553.41	7,533,267.18	11,858,820.59	5,303,370.79	6,555,449.81
11	Durrës	0.25	1,832,861.62	3,192,062.36	5,024,923.98	2,247,191.01	2,777,732.97
12	Elbasan	0.70	5,132,012.52	8,937,774.62	14,069,787.15	6,292,134.83	7,777,652.32
13	Fier	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
14	Finiq	0.15	1,099,716.97	1,915,237.42	3,014,954.39	1,348,314.61	1,666,639.78
15	Fushë-Arrëz	0.59	4,325,553.41	7,533,267.18	11,858,820.59	5,303,370.79	6,555,449.81
16	Gjirokastër	0.05	366,572.32	638,412.47	1,004,984.80	449,438.20	555,546.59
17	Gramsh	0.55	4,032,295.56	7,022,537.20	11,054,832.76	4,943,820.22	6,111,012.53
18	Has	0.54	3,958,981.09	6,894,854.71	10,853,835.80	4,853,932.58	5,999,903.21
19	Himarë	0.55	4,032,295.56	7,022,537.20	11,054,832.76	4,943,820.22	6,111,012.53
20	Kamëz	0.50	3,665,723.23	6,384,124.73	10,049,847.96	4,494,382.02	5,555,465.94
21	Kavajë	0.05	366,572.32	638,412.47	1,004,984.80	449,438.20	555,546.59
22	Këlcyrë	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
23	Klos	0.35	2,566,006.26	4,468,887.31	7,034,893.57	3,146,067.42	3,888,826.16
24	Kolonjë	0.79	5,791,842.71	10,086,917.07	15,878,759.78	7,101,123.60	8,777,636.18
25	Konispol	0.55	4,032,295.56	7,022,537.20	11,054,832.76	4,943,820.22	6,111,012.53
26	Korçë	0.10	733,144.65	1,276,824.95	2,009,969.59	898,876.40	1,111,093.19
27	Krujë	0.05	366,572.32	638,412.47	1,004,984.80	449,438.20	555,546.59
28	Kuçovë	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
29	Kukës	0.39	2,859,264.12	4,979,617.29	7,838,881.41	3,505,617.98	4,333,263.43
30	Kurbini	0.29	2,126,119.47	3,702,792.34	5,828,911.82	2,606,741.57	3,222,170.24
31	Lezhë	0.29	2,126,119.47	3,702,792.34	5,828,911.82	2,606,741.57	3,222,170.24
32	Libohovë	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
33	Librazhd	0.80	5,865,157.17	10,214,599.57	16,079,756.74	7,191,011.24	8,888,745.50
34	Lushnjë	0.34	2,492,691.80	4,341,204.82	6,833,896.61	3,056,179.78	3,777,716.84
35	Malësi e Madhe	0.55	4,032,295.56	7,022,537.20	11,054,832.76	4,943,820.22	6,111,012.53
36	Maliq	0.50	3,665,723.23	6,384,124.73	10,049,847.96	4,494,382.02	5,555,465.94
37	Mallakastër	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
38	Mat	0.80	5,865,157.17	10,214,599.57	16,079,756.74	7,191,011.24	8,888,745.50
39	Memaliaj	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46

40	Mirditë	0.15	1,099,716.97	1,915,237.42	3,014,954.39	1,348,314.61	1,666,639.78
41	Patos	0.44	3,225,836.44	5,618,029.76	8,843,866.21	3,955,056.18	4,888,810.03
42	Peqin	0.39	2,859,264.12	4,979,617.29	7,838,881.41	3,505,617.98	4,333,263.43
43	Përmet	0.34	2,492,691.80	4,341,204.82	6,833,896.61	3,056,179.78	3,777,716.84
44	Pogradec	0.49	3,592,408.77	6,256,442.24	9,848,851.00	4,404,494.38	5,444,356.62
45	Poličan	0.34	2,492,691.80	4,341,204.82	6,833,896.61	3,056,179.78	3,777,716.84
46	Prrenjas	0.70	5,132,012.52	8,937,774.62	14,069,787.15	6,292,134.83	7,777,652.32
47	Pukë	0.69	5,058,698.06	8,810,092.13	13,868,790.19	6,202,247.19	7,666,543.00
48	Pustec	0.29	2,126,119.47	3,702,792.34	5,828,911.82	2,606,741.57	3,222,170.24
49	Roskovec	0.29	2,126,119.47	3,702,792.34	5,828,911.82	2,606,741.57	3,222,170.24
50	Rrogozhinë	0.15	1,099,716.97	1,915,237.42	3,014,954.39	1,348,314.61	1,666,639.78
51	Sarandë	0.35	2,566,006.26	4,468,887.31	7,034,893.57	3,146,067.42	3,888,826.16
52	Selenicë	0.25	1,832,861.62	3,192,062.36	5,024,923.98	2,247,191.01	2,777,732.97
53	Shijak	0.55	4,032,295.56	7,022,537.20	11,054,832.76	4,943,820.22	6,111,012.53
54	Shkodër	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
55	Skrapar	0.14	1,026,402.50	1,787,554.92	2,813,957.43	1,258,426.97	1,555,530.46
56	Tepelenë	0.60	4,398,867.88	7,660,949.68	12,059,817.55	5,393,258.43	6,666,559.13
57	Tiranë	0.05	366,572.32	638,412.47	1,004,984.80	449,438.20	555,546.59
58	Tropojë	0.55	4,032,295.56	7,022,537.20	11,054,832.76	4,943,820.22	6,111,012.53
59	Vau Dejës	0.39	2,859,264.12	4,979,617.29	7,838,881.41	3,505,617.98	4,333,263.43
60	Vlorë	0.05	366,572.32	638,412.47	1,004,984.80	449,438.20	555,546.59
61	Vorë	0.35	2,566,006.26	4,468,887.31	7,034,893.57	3,146,067.42	3,888,826.16



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT  
DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE

Nr. 18133/1 prot.

Tiranë, më 24.12.2025

Lënda: Detajimi i Fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për Bashkitë për Vitin 2025, me Burim Financimi nga Buxheti i Shtetit

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT

DEGËS SË THESARIT

BASHKISË LEZHE ✓

Në zbatim të ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", aneksit 9 "Granti i Performancës për bashkitë", udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr. 1031/5, datë 11.07.2025, dhe nr. 10725, datë 11.07.2025, "Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025", si edhe në vijim të shkresës së Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore nr. 764 Prot., datë 19.12.2025, e cila përcjell vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve në kuadër të GBP 2025, bashkëngjitur, gjeni detajimin e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për vitin 2025, sipas bashkive përkatëse, me burim financimi buxhetin e shtetit (Tabela nr. 1).

Për Grantin e Bazuar në Performancë me burim financimi nga financimi i huaj, detajimi i fondit do të kryhet në momentin e marrjes së vendimeve nga këshillat bashkiakë për destinacionin e përdorimit të tij, në përputhje me përcaktimet e pikës 11.B të udhëzimit të sipërcituar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Besmir Beja




Tabela nr. 1. Granti i Bazuar në Performancë me Burim Financimi: Buxheti i Shtetit

Në lekë

Enit Qev	Gr.	Kod Instit	Emër Institucioni	Nr. Kapit	Nr. Program	Nr. Artik.	Kod. D. Thesarit	Totali
152	00	2152001	Bashkia Belsh	01	04960	6040000	0808	2,157,303.37
102	00	2102001	Bashkia Berat	01	04960	6040000	0202	2,696,629.21
103	00	2103001	Bashkia Bulqize	01	04960	6040000	0603	4,044,943.82
110	00	2110001	Bashkia Cerrik	01	04960	6040000	0808	4,404,494.38
104	00	2104001	Bashkia Delvine	01	04960	6040000	3704	3,955,056.18
105	00	2105001	Bashkia Devoll	01	04960	6040000	1505	1,348,314.61
106	00	2106001	Bashkia Dibër	01	04960	6040000	0606	4,943,820.22
147	00	2147001	Bashkia Divjake	01	04960	6040000	0922	3,505,617.98
452	00	2452001	Bashkia Dropull	01	04960	6040000	1111	5,303,370.79
107	00	2107001	Bashkia Durres	01	04960	6040000	0707	2,247,191.01
109	00	2109001	Bashkia Elbasan	01	04960	6040000	0808	6,292,134.83
111	00	2111001	Bashkia Fier	01	04960	6040000	0909	1,258,426.97
326	00	2326001	Bashkia Finiq	01	04960	6040000	3704	1,348,314.61
155	00	2155001	Bashkia F-Arrez	01	04960	6040000	3330	5,303,370.79
115	00	2115001	Bashkia Gjirokastrë	01	04960	6040000	1111	449,438.20
114	00	2114001	Bashkia Gramsh	01	04960	6040000	0810	4,943,820.22
117	00	2117001	Bashkia Has	01	04960	6040000	1812	4,853,932.58
160	00	2160001	Bashkia Himare	01	04960	6040000	3737	4,943,820.22
166	00	2166001	Bashkia Kamëz	01	04960	6040000	3535	4,494,382.02
118	00	2118001	Bashkia Kavajë	01	04960	6040000	3513	449,438.20
154	00	2154001	Bashkia Kelcyre	01	04960	6040000	1128	1,258,426.97
654	00	2654001	Bashkia Klos	01	04960	6040000	0625	3,146,067.42
120	00	2120001	Bashkia Kolonjë	01	04960	6040000	1514	7,101,123.60
156	00	2156001	Bashkia Konispol	01	04960	6040000	3731	4,943,820.22
122	00	2122001	Bashkia Korçe	01	04960	6040000	1515	898,876.40
123	00	2123001	Bashkia Krujë	01	04960	6040000	0716	449,438.20
124	00	2124001	Bashkia Kuçovë	01	04960	6040000	0217	1,258,426.97
125	00	2125001	Bashkia Kukës	01	04960	6040000	1818	3,505,617.98
126	00	2126001	Bashkia Kurbin	01	04960	6040000	2019	2,606,741.57
127	00	2127001	Bashkia Lezhë	01	04960	6040000	2020	2,606,741.57
116	00	2116001	Bashkia Libohovë	01	04960	6040000	1111	1,258,426.97
128	00	2128001	Bashkia Librazhd	01	04960	6040000	0821	7,191,011.24
129	00	2129001	Bashkia Lushnjë	01	04960	6040000	0922	3,056,179.78
130	00	2130001	Bashkia Malësi e Madhe	01	04960	6040000	3323	4,943,820.22
168	00	2168001	Bashkia Maliq	01	04960	6040000	1515	4,494,382.02
131	00	2131001	Bashkia Mallakastër	01	04960	6040000	0924	1,258,426.97
132	00	2132001	Bashkia Mat	01	04960	6040000	0625	7,191,011.24
143	00	2143001	Bashkia Memaliaj	01	04960	6040000	1134	1,258,426.97
133	00	2133001	Bashkia Mirditë	01	04960	6040000	2026	1,348,314.61
112	00	2112001	Bashkia Patos	01	04960	6040000	0909	3,955,056.18
134	00	2134001	Bashkia Peqin	01	04960	6040000	0827	3,505,617.98
135	00	2135001	Bashkia Permet	01	04960	6040000	1128	3,056,179.78
136	00	2136001	Bashkia Pogradec	01	04960	6040000	1529	4,404,494.38
140	00	2140001	Bashkia Poliçan	01	04960	6040000	0232	3,056,179.78
153	00	2153001	Bashkia Prenjas	01	04960	6040000	0821	6,292,134.83
137	00	2137001	Bashkia Pukë	01	04960	6040000	3330	6,202,247.19
499	00	2499001	Bashkia Pustec	01	04960	6040000	1515	2,606,741.57
113	00	2113001	Bashkia Roskovec	01	04960	6040000	0909	2,606,741.57
119	00	2119001	Bashkia Rrogozhinë	01	04960	6040000	3513	1,348,314.61

138	00	2138001	Bashkia Sarande	01	04960	6040000	3731	3,146,067.42
159	00	2159001	Bashkia Selenice	01	04960	6040000	3737	2,247,191.01
108	00	2108001	Bashkia Shijak	01	04960	6040000	0707	4,943,820.22
141	00	2141001	Bashkia Shkoder	01	04960	6040000	3333	1,258,426.97
139	00	2139001	Bashkia Skrapar	01	04960	6040000	0232	1,258,426.97
142	00	2142001	Bashkia Tepelene	01	04960	6040000	1134	5,393,258.43
101	00	2101001	Bashkia Tiranë	01	04960	6040000	3535	449,438.20
145	00	2145001	Bashkia Tropojë	01	04960	6040000	1836	4,943,820.22
167	00	2167001	Bashkia Dimal	01	04960	6040000	0202	3,505,617.98
157	00	2157001	Bashkia V.Dejes	01	04960	6040000	3333	3,505,617.98
146	00	2146001	Bashkia Vlore	01	04960	6040000	3737	449,438.20
165	00	2165001	Bashkia Vore	01	04960	6040000	3535	3,146,067.42
Shuma								200,000,000.00



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRI I FINANCAVE

MINISTRI I SHTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR

Nr. 10725 Prot. Tiranë, më 11/07/2025

Nr. 10317/15 Prot. Tiranë, më 11/07/2025

UDHËZIM I PËRBASHKËT

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 20 datë 11. 07. 2025

Nr. 01 datë 11. 07. 2025

**“PËR KRITERET, PROCEDURAT, TREGUESIT PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT TË GRANTIT TË BAZUAR NË PERFORMANCË PËR BASHKITË PËR VITIN 2025”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 12 të nenit 15 dhe pikës 6 të Aneksit 9 të ligjit 115/2024, “Për Buxhetin e vitit 2025”, Ministri i Financave dhe Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor.

**UDHËZOJMË :**

**I. Të përgjithshme**

1. Ky udhëzim përcakton kriteret, treguesit dhe procedurat e shpërndarjes së fondit të Grantit të Bazuar në Performancë, i cili do t’u shpërndahet bashkive për vitin 2025.
2. Qëllimi i Grantit të Bazuar në Performancë është:
  - a) të nxisë dhe fuqizojë bashkitë për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e qeverisjes së tyre, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve për gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, në të gjithë territorin ku bashkitë ushtrojnë veprimtarinë e tyre;
  - b) të përmirësojë veprimtarinë e strukturave administrative të bashkive dhe krijimin e një kulture të praktikave të mira në administratën publike vendore;
  - c) të nxisë dhe mundësojë ofrimin e shërbimeve në përputhje me standardet minimale ligjore, sipas legjislacionit në fuqi;
  - ç) të nxisë performancën në një shkallë të lartë, duke krijuar një klimë konkurruese ku bashkitë përpiqen të përmirësojnë shërbimet e ofruara me standarde dhe në përputhje me nevojat specifike për gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, në të gjithë territorin ku bashkitë ushtrojnë veprimtarinë e tyre.
3. Të gjitha bashkitë kanë të drejtë të aplikojnë për të përfituar fonde nga Granti i Bazuar në Performancë, në përputhje me afatet kohore, kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë Udhëzim.
4. Fondet e përfituara nga Granti i Bazuar në Performancë përdoren nga bashkitë sipas nevojave të tyre, me përjashtim të shpenzimeve për personelin dhe shpërblime.

## II. Përkufizime

1. “Granti i Bazuar në Performancë (GBP)” - është një mekanizëm i bashkëfinancuar nga Qeveria Shqiptare dhe nga Qeveria e Konfederatës Zvicerane dhe Qeveria e Suedisë, të përfaqësuara nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), bazuar në marrëveshjen e bashkëfirmosur nga palët sipas Ligjit Nr. 114/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për Projektin “Bashki të Forta (BTF), Faza 2” .
2. “AMVV” - është Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.
3. “Donator” – është Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) / Ambasada e Zvicrës dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA).
4. “KVA” - është Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve të paraqitura nga bashkitë sipas përbërjes së përcaktuar në këtë Udhëzim.

## III. Treguesit për shpërndarjen e Grantit të Bazuar në Performancë

1. Vlerësimi i treguesve do të bëhet bazuar mbi kriteret e qarta, të përcaktuara në Aneksat e këtij Udhëzimi. Në rast se një nga kriteret e treguesit nuk plotësohet treguesi nuk do të vlerësohet.
2. Alokimi/ndarja e fondeve të GBP bëhet mbi bazën e këtyre kushteve:
  - a) përlllogaritja e përafërt mesatare e vlerës së përgatitjes së planeve të përcaktuara si tregues performance për GBP;
  - b) proporcionaliteti me numrin e planeve të përgatitura dhe kriteret e plotësuar;
  - c) përmirësimi i menaxhimit financiar;
3. Bashkitë që kanë aplikuar për GBP dhe që vlerësohen se përmbushin treguesit e përcaktuar në këtë Udhëzim, përfitojnë:
  - a) Një shumë që është proporcionale me peshën e caktuar për secilin tregues, si më poshtë:

Treguesi i GBP	Pesha (%)
Plani i Mbarështimit të Pyjeve	25
Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve	10
Plani Vendor Social	10
Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar	10
Plani Vendor i Integritetit	5
Plani Vendor i Barazisë Gjimore	5
Treguesit e matjes së performancës	5
Treguesi i detyrimeve të prapambetura	10
Treguesi i realizimit të buxhetit	10
Treguesi i taksës mbi pasurinë e paluajtshme	10

- b) Një shumë shtesë të kufizuar, që përlllogaritet proporcionalisht në bazë të fondeve të mbetura pa shpërndarë dhe peshës së treguesve të përmbushur.

#### IV. Procedura administrative për të përfitur nga Granti i Bazuar në Performancë

1. AMVV kryen detyrat e sekretariatit teknik për përgatitjen dhe shpërndarjen e fondit të GBP si dhe kujdeset për zbatimin e praktikave të të gjithë procedurave administrative sipas këtij Udhëzimi.
2. AMVV publikon në faqen zyrtare të internetit dhe njofton me shkrim të gjitha bashkitë për hapjen e thirrjes së aplikimit të GBP dhe dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm për përmbushjen e treguesve të performancës të GBP.
3. Bashkitë dorëzojnë dokumentacionin që përmbush treguesit në AMVV jo më vonë se data 17.09.2025, ora 16.00. Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë bashkitë përcaktohet në Aneksin 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Dokumentacioni që do të dorëzohet nga bashkitë duhet të përmbajë informacion për secilin tregues performance për të cilin do bëhet vlerësimi.
4. AMVV këshillon në vijimësi bashkitë në procesin e përgatitjes së aplikimeve për GBP. Ajo organizon seanca informuese me bashkitë për të shpjeguar rregullat, procedurat, si dhe vendos në dispozicion në faqen zyrtare të internetit praktika dhe modele të ngjashme për hartimin e planeve vendore.

#### V. Vlerësimi i treguesve/planeve të performancës së Grantit të Bazuar në Performancë

1. Vlerësimi i treguesve bëhet në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga bashkitë.
2. AMVV verifikon rregullsinë e dokumentacionit të paraqitur sipas afateve të përcaktuara në Aneksin 1.
3. KVA përbëhet nga 5 pesë anëtarë/anëtare:
  - a) një anëtar/anëtare i propozuar nga Ministri përgjegjës për Pushtetin Vendor;
  - b) një anëtar/anëtare nga Ministria përgjegjëse për Financat;
  - c) një anëtar/anëtare nga Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë, si dhe
  - d) dy anëtarë/anëtare të propozuar nga ministria përkatëse e cila mbulon fushën e përgjegjësisë së treguesit/planit të marrë në vlerësim;

Kryetar i KVA është përfaqësuesi i Ministrit përgjegjës për Pushtetin Vendor.

4. KVA vlerëson dokumentacionin e dorëzuar nga secila bashki sipas kriterëve të përcaktuara në Aneksin 2 dhe 3 që i bashkëlidhen këtij Udhëzimi dhe miraton rezultatin paraprak të vlerësimit. AMVV publikon rezultatet e vlerësimit paraprak në faqen e saj zyrtare të internetit, dhe njofton bashkitë pjesëmarrëse me shkrim, duke i lënë 3 ditë kohë për të paraqitur komentet apo vërejtjet e tyre për vlerësimin e bashkisë përkatëse.
5. Pas përfundimit të afatit të parashikuar në pikën 4 më sipër, brenda 2 ditëve, KVA miraton Vlerësimin Përfundimtar të Aplikimit për çdo Bashki, dhe në vijim AMVV shpall **Tabelën Përfundimtare të Rezultateve të GBP**, e bën atë publike në faqen zyrtare të internetit dhe njofton menjëherë bashkitë me shkrim.
6. Vendimet e KVA për Vlerësimin Përfundimtar të Aplikimit për çdo bashki dhe Tabela Përmbledhëse e shpallur nga AMVV i përcillen nga Drejtori i Përgjithshëm i AMVV Ministrisë së Financave, së bashku me listën për shpërndarjen e fondeve të grantit të performancës për çdo bashki.
7. Në këtë Vendim që i dërgohet Ministrisë së Financave përcaktohet shuma edhe burimi i

financimit të grantit të bazuar në performancë, për secilën prej bashkive përfituese.

8. Përfaqësues nga donatorët kanë të drejtë të jenë të pranishëm në të gjitha procedurat e administrimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të performancës së bashkive dhe të njihen me çdo dokumentacion të paraqitur. Përfaqësuesit/Përfaqësueset e donatorit kanë të drejtë të shprehin qëndrimin e tyre me shkrim drejtuar KVA dhe AMVV-së për çdo fazë të procesit pa shkaktuar vonesa në aplikimin dhe vlerësimin sipas këtij Udhëzimi.

## **VI. Procedura specifike për akordimin e Grantit të Bazuar në Performancë**

1. Granti i bazuar në performancë, për vitin 2025 ka burim financimi:

- a) të brendshëm, në shumën 200 milionë lekë, si zë i veçantë i fondit të akorduar për buxhetin vendor si transfertë e pakushtëzuar sektoriale.
- b) të huaj, në shumën 260 milionë lekë nga Qeveria e Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA).

### **A. Procedurat për akordimin e fondeve me burim financimi të brendshëm të Grantit të Bazuar në Performancë te bashkitë përfituese**

1. Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve pas marrjes së vendimit për bashkitë fituese njofton Ministrinë e Financave duke përcaktuar shumën përkatëse që përfiton çdo bashki për vitin 2025.
2. Ministria e Financave shpërndan fondin te bashkitë përfituese pas marrjes së njoftimit për Vendimin e marrë nga Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve.
3. Granti i performancës në vitin 2025 do të shpërndahet në bashkitë përfituese në formën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale.
4. **Bashkitë kanë pavarësi të plotë të destinacionit të përdorimit të këtij fondi, me përjashtim të shpenzimeve për personelin dhe shpërblime.**
5. **Fondet e papërdorura nga granti i performancës së përfituar nga bashkitë në vitin 2025 me burim financimi transfertën e pakushtëzuar sektoriale, trashëgohen në vitin 2026 për t'u përdorur për të njëjtin destinacion/qëllim.**

### **B. Procedurat për akordimin e fondeve me burim financimi të huaj të Grantit të Bazuar në Performancë te bashkitë përfituese**

1. Fondet e financimit të huaj për Grantin e Bazuar në Performancë përfitohen në formën e dhurimit, pa kusht kthimi, pa interes, mbi bazën e marrëveshjes përkatëse midis Qeverisë së Zvicrës dhe asaj Shqiptare sipas ligjit nr. 114/2024 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për Projektin "Bashki të Forta (BTF), Faza 2", dhe menaxhohen bazuar në Udhëzimin nr.10 datë 12.07.2024 "Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", sipas skemës me thesar të plotë.

2. Disbursimi dhe ekzekutimi i fondeve të Grantit të Bazuar në Performancë bëhet nëpërmjet llogarisë së unifikuar të thesarit (TSA) në Bankën e Shqipërisë (BSH).
3. Për të transferuar fondet nga donatori në TSA në mbështetje të marrëveshjes të miratuar me ligjin nr. 114/2024 të sipërcituar, struktura e përcaktuar për të menaxhuar fondet e financimit të huaj për Grantin e Bazuar në Performancë në ministrinë përgjegjëse për financat, i dërgon zyrtarisht (me firmë të Nëpunësit/Nëpunëses të parë Autorizues) donatorit (Ambasadës Zvicerane/SDC) Formularin e Identifikimit Financiar (FIF) të plotësuar sipas formatit në aneksin nr. 2 të udhëzimit nr.10 datë 12.07.2024 “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”.
4. Formulari i Identifikimit Financiar përveç referencave të TSA, në fushën REMARK përmban edhe kodin e produktit me emërtimin “Grant Performance për Bashkitë”, i cili çelet nga struktura përgjegjëse për Thesarin në qendër me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit.
5. SDC/Ambasada Zvicerane pasi merr Formularin e Identifikimit Financiar të konfirmuar nga ministria përgjegjëse për financat sipas pikës 3 më sipër, kryen disbursimin e financimit të huaj (në euro) duke vendosur në përshkrimin e transfertës bankare të dhënat e fushës REMARK të FIF.
6. Struktura përgjegjëse për thesarin në qendër krediton llogarinë ekonomike “106xxxx” pa specifikuar institucionin dhe ministrinë e linjës, bazuar në njoftimin e Bankës së Shqipërisë.
7. Akordimi i Grantit të Bazuar në performancë tek bashkitë, mbështetet në vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Grantit të Bazuar në Performancë, vendim i cili në momentin e përzgjedhjes së bashkive përfituese i dërgohet zyrtarisht Ministrisë së Financave dhe bashkive nga AMVV.
8. Bashkitë-fituese pasi janë informuar për Vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve bëjnë me dije Këshillin Bashkiak (KB) i cili në përputhje të plotë me përcaktimet e ligjit nr. 139/2015-“Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar merr vendimin për përcaktimin e destinacionit të përdorimit të këtij fondi.
9. Pas marrjes së vendimit nga KB, bashkitë i dërgojnë ministrisë përgjegjëse për financat vendimin e KB për përcaktimin e destinacionit/qëllimit të përdorimit të këtij fondi, duke kërkuar çeljen e kodit të produktit/projektit për të cilin do përdoret ky fond.
10. Bashkitë kanë pavarësi të plotë të destinacionit të përdorimit të këtij fondi, me përjashtim të shpenzimeve për personelin dhe shpërblime.
11. Ministria e Financave, pas marrjes së vendimit të KB dhe kërkesës për çelje kodi bëjnë të mundur çeljen e kodit të produktit/projektit në SIFQ me qëllim më pas transferimin e fondit duke debituar kod institucioni 0000000, ministri linje 00, llogari ekonomike 106xxxx dhe kredituar kod institucioni kodin e bashkisë përkatëse, kod ministrie linje 00, dhe kodin përkatës të produktit/projektit bazuar në kërkesën e bashkive përkatëse.
12. Alokimi i fondeve për shpenzim bëhet me kapitull 02 “Financimi i huaj”.
13. Fondi i pashpërndare në TSA gjatë vitit buxhetor, shpërndahet në vitin buxhetor pasardhës për të njëjtin qëllim, vetëm me vendim të Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve.
14. Gjendja e fondit të prokuruar dhe të papërdorur nga bashkitë në fund të vitit buxhetor trashëgohet në vitin buxhetor pasardhës dhe përdoret për të njëjtat projekte/produkte për të cilin është prokuruar.

15. Gjendja e fondit të ngelur tepricë nga procesi i prokurimit përdoret nga bashkitë për qëllime të tjera që ato gjykojnë dhe vendosin me vendim të këshillit bashkiak.

## VII. Monitorimi, Raportimi dhe Auditimi i Grantit të Bazuar në Performancë

1. Bashkitë mbajnë dhe ruajnë evidencë të plotë të përdorimit të grantit me burim financimi buxhetin e shtetit dhe nga donatorët, dhe raportojnë pranë Ministrisë së Financave mbi progresin e projekteve.
2. Ministria e Financave, bazuar në raportimet e bashkive publikon përdorimin e fondeve të GBP. Raportet u dërgohen donatorëve nga Ministria e Financave.
3. Të gjitha fondet e financuara përmes GBP i nënshtrohen auditimit sipas legjislacionit në fuqi. Auditimi realizohet nga institucione të pavarura të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
4. Donatorët kanë të drejtë të kryejnë monitorime në terren dhe të kërkojnë me shkrim auditimin e përdorimit të fondeve grant të dhëna sipas këtij udhëzimi, për raste të veçanta, kur shuma e grantit është më e madhe se 4 milion lekë, e përdorur në një projekt të vetëm. Në këto raste, auditimi mund të kryhet nga subjekte të angazhuara posaçërisht nga donatorët e grantit dhe shpenzimet e auditimit në këto raste mbulohen nga donatorët.

## VIII. Dispozita të fundit

1. Ngarkohet Ministria e Financave, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe bashkitë për zbatimin e këtij udhëzimi.
2. Institucionet e përfshira në KVA të parashikuara sipas pikës 3 të kreut V të këtij udhëzimi dhe Aneksit 3, të dërgojnë me shkresë zyrtare pranë AMVV-së emrat e përfaqësuesve/përfaqësueseve të tyre brenda 5 ditëve pune nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.
3. Pjesë integrale e këtij Udhëzimi janë anekset, bashkëlidhur si më poshtë:

*Aneksi 1:* “Afatet Kohore për procedurën e aplikimit, shpërndarjes dhe përdorimit të GBP”;

*Aneksi 2:* “Vlerësimi nga AMVV i dokumentacionit të paraqitur nga Bashkitë”;

*Aneksi 3:* “Vlerësimi nga KVA i cilësisë së Planeve të paraqitura nga Bashkitë dhe treguesve financiarë të performancës”;

*Aneksi 4:* “Përlllogaritja e shumave që përfitojnë bashkitë”;

4. Shpërndarja e GBP për vitin pasardhës do të rregullohet me dispozita shtesë.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE

MINISTRI I SHTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR

Petrit Malaj



Arbjan Memiku

